VENDIM
Nr.300, datë 25.5.2007

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.352, DATË 3.5.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË SË PASURIVE TË PALUAJTSHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1/a të vendimit nr.352, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1/b me këtë përmbajtje:

"1/b. Certifikata e vërtetimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme përmban elemente sigurie, një numër serial gjashtëshifror, unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe mbi të aplikohet vula metalike (e thatë).

- Forma dhe modeli i certifikatës së vërtetimit të pronësisë përcaktohen në aneksin A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Elementet e sigurisë së certifikatës se vërtetimit të pronësisë përcaktohen në aneksin B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha